

# 20

## Situata të të shkruarit, të cilat janë veçanërisht të përshtatshme për mësimin në gjuhën e prejardhjes

### Qëllimi

Shumë nga idetë e shfletuara deri më tash mundësojnë që pa problem të merren në mësimin e gjuhës së prejardhjes. Situatat vijuese të të shkruarit janë nxitje të tjera pér këtë. Ato qëndrojnë në lidhje të ngushtë tematike qoftë me vendin e prejardhjes ose pér jetën në dhe mes dy kulturave dhe gjuhëve, ashtu si edhe është karakteristike pér nxënësit/et e mësimit në gjuhën e prejardhjes.

### 1. Tekste me gjëegjëza

kl. 4–9

30 min.



N marrin pér detyrë pér të përshkruar diçka nga historia, kultura ose gjeografija e vendit të prejardhjes, pa e përmendur emrin e ngjarjes përkatëse, gjegjësisht personalitetit përkatës ose të qytetit. Tema do të duhej të kufizohet në kuadër të historisë, kulturës, gjeografisë ose të personaliteteve. Ushtrimi mund të bëhet së pari me gojë, në vazhdim duhet që gjëegjëzat të formulohen me shkrim, të mblidhen dhe të shkëmbehen.

### 2. Reportazhet, pllakatet, referatet

kl. 3–9



Tek ky projekt i madh mësimor N krijojnë një reportazh, një pllakat ose një referat pér një vend, një ngjarje ose personalitet nga vendi i prejardhjes. Forma e krijimit do të diskutohet me N (p.sh. pllakat ose referat me fletën përkatëse të punës). Kërkosat natyrisht do të caktohen sipas moshës. Pér projektin (përfshirë prezantimin) duhet të llogariten dy ose më shumë orë dyshe. Është e arsyeshme që të bëhet e ditur para pushimeve të gjata, ashtu që N gjatë pushimeve të mund të mbledhin material dhe të përgatiten.

### 3. Fletët e punës, tekste tematike, kuiz etj.

kl. 4–9

45 min.



Në vend që M pér mësimin në gjuhën e prejardhjes të bëjë gati fletët e punës, tekstet tematike, fotografitë, prezantimet përmes kompjuterit etj. këtë mund ta bëjnë nganjëherë edhe nxënësit/et shumë mirë. Me këtë rast ata edhe mësojnë gogja dhe e përsëritin përbajtjen. Me rëndësi është që paraprakisht të merren vesh, se çfarë duhet të krijohet (p.sh. një fletë pune ose një kuiz me rastin e përfundimit të një teme).

### 4. Intervistat, intervistat fiktive

kl. 5–9



N marrin pér detyrë pér të zhvilluar intervista pér një temë të caktuar bashkërisht që më parë, këtë t'a dokumentojnë me shkrim dhe t'ia prezantojnë klasës. Tema të mundshme dhe partnerët/et intervistues/e: Kujtimet e prindërvë ose gjyshërve tanë pér fëmijërinë e tyre në vendin e prejardhjes / Intervistë me dikë që është moshatar në vendin e prejardhjes pér temën koha e lirë dhe perspektivat pér të ardhmen / Intervistë me njerëzit në vendin në të cilin N jetojnë, pér temat si racizmi, të huajt, integrimi. Me rëndësi: paraprakisht duhet të diskutohet me N se si bëhet një intervistë: të shënohen pyetjet kryesore, pyetjet e hapura të formulohen (jo pyetje po/jo, por më shumë impulse: «Tregoni ju lutem pak, ...», intervistues/i ja vetë të flas pak. Edhe forma e dokumentimit me shkrim duhet të sqarohet: Jo të shkruhet gjithçka fjalë pér fjalë, por të përmblidhet. Një mjet pér inçizim: magnetofon ose telefon i dorës.

Variant nxitës: të sajohen dhe të shënohen intervista fiktive me personalite të mëdha nga kultura ose politika kombëtare.

### 5. Kërkesa, thirrje

kl. 5–9

45 min.



Në vazhdim të diskutimeve të gjendjeve të pakënaqshme ose të ngjarjeve në vendin e prejardhjes ose në vendin e tanishëm, do të mendohet se kujt do të mund t'i drejtohen me një kërkësë pér përmirësimin e gjendjes ose si do të dukej një thirrje pér gazetat. Në vazhdim N i shkruajnë tekstet përkatëse dhe i diskutojnë bashkërisht. Se a do të dërgohen kërkosat vërtet apo do të shërbejnë vetëm si tekste fiktive, duhet të vendoset nga rasti